

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 002 / 2026	0
Projekti: Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit	Data e publikimit: 12 Janar 2026 Data e dorëzimit: 12 Shkurt 2026	



KËRKESË PËR TENDER (KPT)

01. Informacion i Përgjithshëm i Tenderit

1.1. Oferta e kërkuar nga: Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit: Rruga "SH81", Parku Kombëtar i Butrintit, Ksamil, Shqipëri.

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit (FMB) është një organizatë jofitimprurëse pa anëtarësi, e bashkëthemeluar nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) dhe Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim.

FMB operon në fushën e trashëgimisë kulturore dhe ka për qëllim administrimin indirekt të nënjonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e PKB ("Pasuria Kulturore"), në përputhje me Marrëveshjen e miratuar me Ligjin 50/2022 "Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënjonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit".

1.2. Objekti i Kërkesës për Tender: Ofrimi i Shërbimeve për "Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit". Më shumë detaje rreth fushës së shërbimit gjenden në Termat e Referencës, të cilat janë pjesë e pandarë e dokumentacionit të tenderit.

1.3. Burimi i Financimit dhe fondi limit: Kjo Kërkesë për Tender financohet nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit. Fondi limit për këtë KPT është: 5,008,800 Lekë me Tvsh.

1.4. Mashtrimi dhe Korrupsioni: Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit kërkon që furnitorët, kontraktorët dhe konsulentët sipas kontratave të tij ose kontratave të tilla të kërkuara, të respektojnë standardet më të larta të etikës gjatë prokurimit dhe ekzekutimit të kontratave. Në ndjekje të një politike të tillë, Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit përcakton për qëllimin e kësaj dispozite, kushtet e përcaktuara si më poshtë:

- a) "Praktikë korruptive" nënkupton ofertën, dhënien, marrjen ose kërkimin e çdo gjëje me vlerë për të ndikuar në veprimin e punonjësve apo drejtuesve të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit në procesin e prokurimit ose në ekzekutimin e kontratës.
- b) "Praktikë mashtruese" nënkupton një keqinterpretim të fakteve me qëllim që të ndikojë në një proces prokurimi ose ekzekutimin e një kontrate në disfavor të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit dhe përfshin praktikën e fshehta të marrëveshjeve të paligjshme midis Ofertuesve (para ose pas paraqitjes së Ofertave) të krijuara për të përcaktuar çmimet e Ofertave në nivele artificiale, jo konkurruese dhe t'i privojnë Fondacionit përfitimet e konkurrencës së lirë dhe të hapur.

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit do të refuzojë një ofertë nëse konstaton se Ofertuesi është përfshirë në praktika korruptive ose mashtruese në konkurrim për kontratën. Fondacioni

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 002 / 2026	0
Projekti: Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit	Data e publikimit: 12 Janar 2026 Data e dorëzimit: 12 Shkurt 2026	

për Menaxhimin e Butrintit do të deklarojë gjithashtu një entitet si të papërshtatshme për t'i dhënë një kontratë, qoftë për një kohë të pacaktuar ose për një periudhë të caktuar kohore, nëse konstaton se entiteti është përfshirë në praktika korruptive ose mashtruese në konkurrim ose në ekzekutimin e një kontrate të financuar nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit.

Ndalohet kontakti i drejtpërdrejtë me punonjësit ose drejtuesit e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit në lidhje me paraqitjen e ofertave gjatë periudhës së vlerësimit të ofertave.

Çdo përpjekje e Ofertuesve për të ndikuar përfaqësuesit e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit në vlerësimin e ofertave ose vendimeve për dhënien e kontratës do të rezultojë në refuzimin e menjëhershëm të ofertave të tyre.

1.5. Pranueshmëria e Ofertuesve: Ofertuesit nuk mund të konkurrojnë nëse:

- 1- Nuk janë kompani të regjistruara.
- 2- Janë të falimentuar ose në proces falimentimi / likuidimi.
- 3- Kanë qenë fajtorë për shkelje të rënda profesionale, përfshirë keqinterpretimin serioz në dhënien e informacionit dhe shkeljen e detyrimeve të tyre kontraktuale.
- 4- Nuk kanë përmbushur detyrimet lidhur me pagesën e sigurimeve të detyrueshme, sigurimet shoqërore dhe taksat.
- 5- Janë në ndonjë listë të subjekteve të sanksionuara të lëshuara nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara, Kombet e Bashkuara ose Bashkimi Evropian ose Agjencia e Prokurimit Publik.
- 6- Janë në konflikt interesi. Një Ofertues konsiderohet të ketë konflikt interesi në rast se, por nuk kufizohen: (i) ka një marrëveshje kompensimi ose interes tjetër në një transaksion me Fondacionin; (ii) ka një rrethanë tjetër që, në fakt ose në dukje, mund ta vështirësojë ushtrimin e pavarësisë, gjykimin objektiv ose në ndonjë mënyrë tjetër kryerjen me efektivitet të detyrave si kontraktor; (iii) ka të njëjtin drejtues ligjor me një Ofertues tjetër; (iv) ka marrë pjesë në hartimin e termave të referencës të procedurës në fjalë; (v) ka lidhje familjare ose biznesi me stafin e Fondacionit.
- 7- Një Ofertues mund të jetë një subjekt i vetëm ose një bashkim subjektësh sipas një marrëveshjeje ekzistuese ose sipas një letre qëllimi e shoqëruar me një marrëveshje për krijimin e një bashkimi subjektësh në rastin e shpalljes fitues. Një Ofertues që vendos të konkurrojë i vetëm ose si bashkim subjektësh nuk duhet të dorëzojë më shumë se një ofertë. Në një rast të tillë, të gjithë ofertat do të refuzohen.
- 8- Në rastin e bashkimit të subjekteve ose qëllimit për të krijuar një bashkim subjektësh, numri i subjekteve anëtarë të bashkimit nuk duhet të jetë më shumë se dy. Të gjithë anëtarët e bashkimit të subjekteve do të jenë bashkërisht dhe vecmas përgjegjës për ekzekutimin e kontratës. Bashkimi i subjekteve do të caktojë një përfaqësues, i cili do të jetë i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet për dhe në emër të bashkimit të subjekteve gjatë procesit të prokurimit dhe ekzekutimit të kontratës, në rast se shpallet fitues.
- 9- Janë sanksionuar për mashtrim dhe korrupsion, sipas pikës 1.4, nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara, Kombet e Bashkuara ose Bashkimi Evropian ose Agjencia e Prokurimit Publik.
- 10- Mos plotësimi i kritereve të tjera kualifikuese.

2. Përmbajtja e Dokumenteve të Tenderit:

2.1. Dokumentet e Tenderit: Dokumentet e Tenderit merren nëpërmjet kërkesës me email në tenders@bmf.al nga faqja zyrtare e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, <https://bmf.al/>.

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 002 / 2026	0
Projekti: Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit	Data e publikimit: 12 Janar 2026 Data e dorëzimit: 12 Shkurt 2026	

Nëse keni pyetje, ato duhen drejtuar me shkrim me e-mail në tenders@bmf.al ose me shkresë në adresën e mësipërme. Format e tjera të komunikimit në lidhje me ofertat nuk pranohen gjatë një procedure në vazhdim.

Të gjithë Ofertuesit do të marrin dokumente identike. Fondacioni nuk mban përgjegjësi nëse dokumentet e tenderit nuk merren direkt nga adresa e sipërcituar. Asnjë Ofertues nuk duhet të shtojë, heqë ose ndryshojë ndonjë term ose kusht në dokumentet origjinale. Nëse e bëjnë, kjo do të jetë arsye për skualifikim të menjëhershëm.

2.2. Përmbajtja e dokumenteve të Tenderit: Dokumentet e Tenderit përbëhen nga:

- Kjo Kërkesë për Tender,
- Formularët e Ofertës
- Termat e Referencës
- Draft kontrata
- Formularët e kontratës.

2.3. Vizitë në terren: Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit do të organizojë një vizitë në terren më datë 30 Janar 2026. Ofertuesit e interesuar duhet të konfirmojnë paraprakisht me shkrim pjesëmarrjen në vizitën në terren në adresën tenders@bmf.al. Qëllimi i kësaj vizite është vetëm njohja me kushtet e terrenit, por nuk do të jepet asnjë informacion shtesë apo sqarim mbi dokumentet e tenderit nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit. Çdo kërkesë për sqarim do të bëhet sipas paragrafit 2.4. Të gjitha shpenzimet për vizitën në terren do të përballohen nga ofertuesit.

2.4. Sqarimi i dokumenteve të tenderit: Sqarimet në lidhje me dokumentin e tenderit duhet t'i dërgohen me shkrim Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit jo më vonë se gjashtë ditë pune përpara afatit të dorëzimit. Kërkesat mund të dërgohen me e-mail në tenders@bmf.al ose të dërgohen me shkrim në zyrën e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit në Sarandë. Përgjigjet për çdo pyetje të ngritur nga çdo Ofertues do t'i jepen me shkrim, nëse është e mundur, brenda tre ditëve të punës, të gjithë Ofertuesve të interesuar, pa identifikuar Ofertuesin që ka kërkuar sqarimin. Megjithatë, është kusht i kësaj Kërkese për Tender që asnjë sqarim nuk do të konsiderohet se zëvendëson, kundërshton, shton ose pakëson kushtet e saj, përveç nëse ndryshimet bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga Drejtori Ekzekutiv ose përfaqësuesi i tij i caktuar.

2.5. Ndryshimi i Dokumentit të Tenderit: Në çdo kohë para afatit të fundit për dorëzimin e ofertave, Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit mund të ndryshojë Dokumentin e Tenderit duke lëshuar një shtesë. Çdo shtesë e lëshuar do të jetë pjesë e Dokumentit të Tenderit dhe do t'u komunikohet me shkrim të gjithë atyre që kanë marrë Dokumentin e Tenderit dhe janë regjistruar. Një njoftim në lidhje me shtesa të tilla do të publikohet në faqen e internetit të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, <https://bmf.al/>. Për t'u dhënë Ofertuesve të mundshëm kohë të arsyeshme për të marrë parasysh një shtesë në përgatitjen e ofertave të tyre, Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, sipas gjykimit të tij, mund të zgjasë afatin për dorëzimin e ofertave.

3. Përgatitja e Ofertës

3.1. Gjuha: Siç përcaktohet nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, gjuha e ofertës është gjuha shqipe dhe çdo dokument, kontrata, certifikata, referenca të marra nga palë të

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 002 / 2026	0
Projekti: Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit	Data e publikimit: 12 Janar 2026 Data e dorëzimit: 12 Shkurt 2026	

treta në gjuhë të ndryshme nga ajo shqipe, duhet të përkthehen. Noterizimi nuk është i domosdoshëm, por kopjet e noterizuara do t'i kërkojnë fituesit nga Fondacioni për lidhjen e kontratës.

3.2. Kostoja e Ofertës: Ofertuesi do të përballojë të gjitha kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tij dhe Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit në asnjë rast nuk do të jetë përgjegjës për ato kosto, pavarësisht nga zhvillimi ose rezultati i procesit të prokurimit. Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit nuk është i detyruar të pranojë çdo ofertë dhe rezervon të drejtën të anulojë procesin e prokurimit në çdo kohë para dhënies së kontratës, pa patur asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve.

3.3. Paraqitja e Ofertës: Oferta do të përmbajë zarfet e mëposhtëm:

- Një zarf “Origjinal” të Ofertës Teknike, të vulosur, i cili do të përmbajë vetëm informacion teknik dhe do të shënohet “Origjinal - Oferta Teknike”.
- Një zarf “Origjinal” të Ofertës Financiare, të vulosur, i cili do të përmbajë vetëm informacion financiar dhe do të shënohet “Origjinal - Oferta Financiare”.
- Një zarf “Kopje” të Ofertës Teknike, të vulosur, i cili do të përmbajë një kopje të dokumenteve teknike dhe do të shënohet “Kopje - Oferta Teknike”.
- Një zarf “Kopje” të Ofertës Financiare, të vulosur, i cili do të përmbajë një kopje të dokumenteve financiare dhe do të shënohet “Kopje - Oferta Financiare”.
- Një zarf “Kopje Elektronike”, i cili do të përmbajë një USB plotësisht funksionale dhe të pastër nga viruset. Skanimi i dokumentacionit të ofertës në USB do të bëhet në dy skedarë, një për Ofertën Teknike dhe një për Ofertën Financiare. Brenda secilit skedar, çdo dokument duhet të skanohet dhe ruhet veçmas, me tituj që tregojnë qartë përmbajtjen.

3.4. Dokumentet që përbëjnë Ofertën:

a. Oferta Teknike do të përmbajë:

- *Autorizimin për nënshkrimin e Ofertës*, një konfirmim me shkrim i cili autorizon përfaqësuesin e Ofertuesit të nënshkruajë ofertën dhe të mbajë përgjegjësi për të.

- *Dokumentacionin që vërteton pranueshmërinë dhe kualifikimin e Ofertuesit:*

- Ekstrakt historik nga Regjistri Tregtar, të lëshuar nga QKB, të lëshuar jo më herët se 30 ditë nga data e dorëzimit.
- Të mos jetë në proces falimentimi dhe/ose likuidimi (statusi aktiv).
- Vërtetim se përfaqësuesi ligjor dhe aksionarët/ortakët e shoqërisë nuk janë dënuar për shkelje penale, si dhe nuk janë nën proces hetimi nga ana e organit të prokurorisë, të lëshuar jo më herët se 30 ditë nga data e dorëzimit;
- Vërtetim nga gjykata se subjekti nuk ka proces gjyqësor të hapur në cilësinë e palës së paditur, të lëshuar jo më herët se 30 ditë nga data e dorëzimit;
- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore të lëshuar nga autoritetet përkatëse tatimore, të lëshuar jo më herët se 30 ditë nga data e dorëzimit;

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 002 / 2026	0
Projekti: Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit	Data e publikimit: 12 Janar 2026 Data e dorëzimit: 12 Shkurt 2026	

- Deklaratë mbi mospërfshirjen në ndonjë listë me sanksione të lëshuar nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara, Kombet e Bashkuara ose Bashkimi Evropian, ose Agjencia e Prokurimit Publik.
- Deklaratë se nuk janë fajtorë për shkelje të rënda profesionale, përfshirë keqinterpretime serioze në dhënen e informacionit, mashtrim dhe korrupsion dhe shkelje të detyrimeve kontraktuale.
- Deklarimi i konfliktit të interesit me çdo drejtor apo menaxher të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, nëse ka. Mungesa e një deklarimi të tillë, nëse ekziston konflikti, do të çojë në përjashtimin nga prokurimi aktual dhe përjashtimin e mundshëm nga procedurat e ardhshme të prokurimit.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklarimit të Ofertuesit, në ditën e hapjes së ofertave, sipas Formularit nr. 3. Formular vetëdeklarimi. Dokumentacioni vërtetues kërkohej për pikat 1- 5 më lart dhe do të dorëzohet nga Ofertuesi i renditur i pari në klasifikimin e Ofertuesve.

- Dokumentacionin që vërteton përputhshmërinë me kërkesat teknike:

- Një CV të shoqërisë për aktivitetin e saj për jo më pak se 10 vite në fushën e kërkuar, ku të përfshihen kontaktet e përfaqësuesve të institucioneve kontraktuese për referencë (person kontakti, nr. telefoni dhe adresë email). Në rastin e bashkimit të subjekteve, kjo kërkesë duhet të përmbushet nga secili prej anëtarëve.
- Metodologjia e propozuar në përputhje me Termat e Referencës.
- Licencë profesionale për ndërhyrjet në Pasuritë kulturore materiale (lëshuar nga KKTKM, pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore) **ose Kontratë Shërbimi ose Marrëveshje Bashkëpunimi që disponojnë licensën e mësipërme ku të përfshihen kategoritë:**

PROJEKTUES RESTAURATOR

Për individ:

P/A/1. Projektim në konservim dhe restaurim i rrënojave/siteve arkeologjike;

P/A/2. Projektim në konservim dhe resturim i ndërtimeve me karakter mbrojtës.

ose

Për person juridik:

N-P/A/1. Projektim në konservim dhe restaurim i rrënojave/siteve arkeologjike;

N-P/A/2. Projektim në konservim dhe resturim i ndërtimeve me karakter mbrojtës.

Në rastin e bashkimit të subjekteve, kjo kërkesë duhet të përmbushet nga të paktën një prej anëtarëve të bashkimit të subjekteve.

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 002 / 2026	0
Projekti: Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit	Data e publikimit: 12 Janar 2026 Data e dorëzimit: 12 Shkurt 2026	

4. Liçensat profesionale të Konsulentit ose të personave të kontraktuar (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategoritë:

- PROJEKTUES ARKITEKT

b-2) Qendra tregtare; objekte social-kulturore; objekte kulti; objekte arsimore;

c- Projektim interiere;

- PROJEKTUES KONSTRUKTOR

a) Projektim objekte civile – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

- PROJEKTUES INSTALATOR

a) Projektim të instalimeve hidrosanitare;

b) Projektim të instalimeve ventilim-kondicionim;

c) Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile;

f) Projektim të sistemeve kundra zjarrit.;

j) Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, akses kontroll, CCTV, sistemet e alarmit për objektet civile.

- PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

a) Projektim furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.

Në rastin e bashkimit të subjekteve, kjo kërkesë duhet të përmbushet nga të paktën një prej anëtarëve të bashkimit të subjekteve.

5. Kontrata të ngjashme ose referenca projektimi në zona arkeologjike ose të mbrojtura, etj. Në rastin e bashkimit të subjekteve, kjo kërkesë duhet të përmbushet bashkarisht nga të gjithë anëtarët. Plotësoni saktë Formularin nr. 4 për eksperiencat e ngjashme.
6. Lista e emrave të ekipit kryesor të planifikuar për të punuar në këtë projekt të shoqëruar me CV-të, diplomat, kontratë bashkëpunimi me ekspertët nëse nuk do të jenë punonjës të kompanisë dhe licencat e tyre (aty ku është e aplikueshme), sipas Formularit nr. 5 për ekipin kryesor.

Pjesë e grupit të projektimit, me pozicione të licencuar sipas pikave 3 dhe 4 më lart, duhet të jenë:

- Projektues Restaurator; Sipas VKM Nr. 792 dt. 07.10.2020, i ndryshuar me VKM Nr. 329, dt.02.06.2021
- Projektues Arkitekt;
- Projektues Konstruktor;
- Projektues mekanik
- Projektues elektrik;
- Arkeolog
- Projektues Hidroteknik
- Specialist Muzesh
- Specialist VR

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 002 / 2026	0
Projekti: Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit	Data e publikimit: 12 Janar 2026 Data e dorëzimit: 12 Shkurt 2026	

Ofertuesi duhet të propozojë vetëm një ekspert për secilin pozicion. Dorëzimi i CV alternative për të njëjtin pozicion mund të rezultojë në refuzimin e ofertës.

b. Oferta Financiare do të përmbajë:

Formularin e Ofertës , sipas Formularit nr. 1. Formulari i Ofertës (original) .

Buxhetin e detajuar, sipas Formularit nr. 2. Buxheti i detajuar (original).

Këta formularë do të plotësohen nga Ofertuesi në hapësirat boshe, pa ndryshuar përmbajtjen e tyre. Mosplotësimi ose ndryshimi i këtyre formularëve përbën shkak për skualifikim.

Fituesit do t'i kërkohet të dorëzojë kopjet origjinale ose të noterizuara të të gjithë dokumenteve të Ofertës së tij. Çdo ndryshim i dokumenteve do të jetë shkak për dënime të ashpra, deri në përjashtim të përhershëm nga prokurimi në Fondacionin për Menaxhimin e Butrintit.

3.2. Rasti i bashkimit të subjekteve: Përvec dokumentave të kërkuara në pikën 3.4, oferta e paraqitur nga një bashkim subjektesh duhet të përmbajë marrëveshjen e bashkëpunimit ose një letër të nënshkruar nga subjektet që synojnë krijimin e një bashkimi subjektesh në rastin e shpalljes fitues, si dhe prokurën që cakton një përfaqësues që do të veprojë për dhe në emër të bashkimit të subjekteve gjatë gjithë procesit të prokurimit dhe zbatimit të kontratës, sidhe për kryerjen e pagesave, në rast të shpalljes fitues.

3.3. Çmimet e Ofertave:

Çmimi i kuotuar në Formularin e Ofertës do të jetë çmimi total i Ofertës. Ky çmim duhet të përfshijë të gjitha kostot që lidhen me shërbimin, pagesat e detyrueshme, taksat dhe detyrimet. TVSH-ja do të llogaritet dhe tregohet veçmas në mënyrën e treguar në formularët përkatës.

Monedha e Ofertës është Lekë.

3.4. Vlefshmëria e Ofertës: Çdo ofertë do të jetë i vlefshëm për të paktën 150 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të saj.

3.5. Nënshkrimi i Ofertës: Oferta do të nënshkruhet nga personi i autorizuar nga Ofertuesi nëpërmjet një autorizimi me shkrim. Në rastin e bashkimit të subjekteve, oferta nënshkruhet nga përfaqësuesi i autorizuar nga bashkimi i subjekteve, në emër të bashkimit të subjekteve, dhe është detyrues për të gjithë anëtarët e bashkimit të subjekteve.

4. Dorëzimi i Ofertës:

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 002 / 2026	0
Projekti: Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit	Data e publikimit: 12 Janar 2026 Data e dorëzimit: 12 Shkurt 2026	

4.1. Paketimi final i dokumentacionit: Pasi të jenë përgatitur dhe etiketuar të gjitha zarfet sipas udhëzimeve në pikën 3.3, ato duhet të vendosen së bashku në një paketë të vetme të mbyllur dhe të vulosur. Në pjesën e jashtme të paketës duhet të shënohet qartë:

- a) Emri dhe adresa e Ofertuesit
- b) Drejtuar: Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit; Adresa: Rruga "SH81", Parku Kombëtar i Butrintit, Ksamil, Shqipëri.
- c) Objekti dhe numri i referencës së prokurimit
- d) Paralajmërimi: "TË MOS HAPET PARADATËS DHE ORËS SË CAKTUAR PËR HAPJEN E OFERTAVE"

4.2. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (me zarf të mbyllur) është data 12 Shkurt 2026, ora 11:00.

4.3. Oferta mund të paraqitet personalisht ose me postë në zyrën e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit në Sarandë (adresa e dhënë më sipër).

Për dorëzimin e ofertave që bëhet përmes postës do të merret në konsideratë data dhe ora e dorëzimit sipas vulës së postës, e cila duhet të jetë brenda afatit të fundit për dorëzimin e ofertave. Ofertat e dorëzuara pas këtij afati, do të refuzohen dhe do të kthehen nga Fondacioni të pahapura. Në rast të dorëzimit me postë, Ofertuesi duhet të njoftojë Fondacionin për këtë, përndryshe Fondacioni nuk ka detyrim të presë ofertën deri në hapjen e ofertave.

4.4. Fondacioni mund të shtyjë afatin e dorëzimit të ofertave, sipas gjykimit të tij, nëpërmjet një amendimi të Kërkesës për Tender.

4.5. Tërheqja, zëvendësimi dhe modifikimi i ofertave: Një Ofertues mund të tërheqë, zëvendësojë ose modifikojë Ofertën e tij pasi të jetë dorëzuar duke dërguar një njoftim me shkrim, të nënshkruar siç duhet nga një përfaqësues i autorizuar. Të gjitha njoftimet duhet të merren nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit përpara afatit të përcaktuar për dorëzimin e ofertave. Ofertat e tërhequra do t'u kthehen të pahapura Ofertuesve. Asnjë ofertë nuk mund të tërhiqet, zëvendësohet ose modifikohet në intervalin ndërmjet afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe skadimit të periudhës së vlefshmërisë së ofertave të specifikuar nga Ofertuesi në formularin e ofertës ose në ndonjë zgjatje të tyre.

5. Hapja dhe vlerësimi i ofertave

5.1. Hapja e ofertave: Në rastet kur priten oferta me postë, Fondacioni do të hapë ofertat ose në momentin që të gjithë ofertat e pritura kane arritur ose 7 ditë kalendarike pas afatit të fundit për dorëzimin e ofertave, në orën e parashikuar, cilado nga këto ngjarje të realizohet e para. Ofertat do të hapen nga përfaqësuesit e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit. Emri i Ofertuesit, tërheqje / zëvendësime / modifikime, cmimi total i ofertës do të shpallen dhe regjistrohen në procesverbalin e hapjes së ofertave, i cili u dërgohet Ofertuesve që kanë dorëzuar oferta.

5.2. Vlerësimi i Ofertave: Komiteti i Vlerësimit të Tenderit (KVT) do të kontrollojë ofertat për t'u siguruar që ato nuk përmbajnë ndryshime në terma ose gabime. Për të

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 002 / 2026	0
Projekti: Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit	Data e publikimit: 12 Janar 2026 Data e dorëzimit: 12 Shkurt 2026	

ndihmuar në ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave, KVT, sipas gjykimit të tij, mund të kërkojë ndihmë nga profesionistë të tjerë në cilësinë e konsulentit të KVT. Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit do të vlerësojë vetëm në bazë të ofertave teknike dhe financiare të dorëzuara dhe përputhshmërinë e tyre me Termat e Referencës dhe Kërkesën për Tender. Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit rezervon të drejtën të pranojë ose refuzojë çdo, të gjitha, ose një pjesë të ofertave të paraqitura pa dhënë arsye për një vendim të tillë.

5.3. Ekzaminimi paraprak i Ofertave: KVT do të verifikojë nëse ofertat janë firmosur sic duhet dhe nëse janë dorëzuar të gjithë formularët e kërkuar.

5.4. Vlerësimi i kriterëve të pranueshmërisë dhe kualifikimit: KVT do të verifikojë nëse ofertat plotësojnë kriteret e pranueshmërisë dhe kualifikimit.

5.5. Vlerësimi Teknik: Ofertat do të vlerësohen fillimisht për cilësitë teknike, duke vlerësuar kapacitetin e kompanisë përmes dokumentacionit të dorëzuar. Mangësitë mund të ndikojnë në rezultatet dhe mundësinë për të fituar. Pragjet e cilësisë janë vendosur si në tabelë:

Nr.	Kriteret	Pesha
1.	Eksperienca të ngjashme, Kualifikimet dhe përvoja e ekipit kryesor	30%
2.	Metodologjia e propozuar	30 %
3.	Oferta financiare	40%
	Total	100

Ofertat që shënojnë më pak se **60%** për të paktën një kriter cilësor dhe më pak se **70%** për kriteret cilësore në përgjithësi, do të përjashtohen nga pjesa tjetër e procedurës së vlerësimit.

5.6. Korrigjimi i gabimeve aritmetike: aktivitetet dhe zërat e përfshirë në ofertën teknike, për të cilët nuk është përcaktuar çmimi në ofertën financiare, do të supozohen të përfshirë në çmimet e aktiviteteve apo zërave të tjerë dhe asnjë korrigjim nuk do t'i bëhet ofertës financiare.

5.7. Vlerësimi financiar pason vlerësimin teknik dhe bazohet në kosto. Kriteri i koston vlerësohet duke i dhënë numrin maksimal të pikëve në dispozicion për kriterin e koston ofertës më të ulët të kualifikuar. Pjesa tjetër e ofertave vlerësohet duke përdorur një formulë që lejon vlerësimin proporcional të pikëve.

5.8. Ofertat anomalisht të ulëta: Ofertat do të shqyrtohen nga afër për të përcaktuar **anomalitë e çmimeve**. Ofertat që vlerësohen nga Komiteti i Vlerësimit të Tenderit si anomalisht të ulëta do të skualifikohen mbi këtë bazë, pavarësisht nga pikët e tyre teknike. Ky vendim kërkon verifikim, i cili përfshin edhe Ofertuesin.

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 002 / 2026	0
Projekti: Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit	Data e publikimit: 12 Janar 2026 Data e dorëzimit: 12 Shkurt 2026	

5.9. Tejkalimi i fondit limit:

Ofertat me një çmim më të lartë se fondi limit i treguar në pikën 1.3 do të përjashtohen nga pjesa tjetër e procedurës së vlerësimit.

5.10. Përzgjedhja e fituesit: Përzgjedhja e Ofertuesit të suksesshëm do të bazohet në renditjen e ofertave të kualifikuara sipas pikëve kumulative të fituara nga vlerësimi i kriterëve teknike dhe financiare.

6. Dhënia e kontratës: Brenda periudhës së vlefshmërisë së ofertave, Fondacioni do të njoftojë me shkrim Ofertuesin e suksesshëm për pranimin e ofertës, nëpërmjet Formularit nr. 6. Letra e Pranimit, ku do të kërkohet edhe konfirmimi i ekipit kryesor.

Ofertuesit të suksesshëm do t'i kërkohet të dorëzojë kopjet e noterizuara të të gjithë dokumenteve të Ofertës. Çdo ndryshim i dokumenteve do të jetë shkak për dënime të ashpra, deri në përjashtim të përhershëm nga tenderimi në Fondacionin për Menaxhimin e Butrintit. Në rastin e shpalljes fitues të një bashkimi subjektesh, do të kërkohet dorëzimi i kopjes së noterizuar të marrëveshjes së bashkimit të subjekteve para nënshkrimit të kontratës.

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 002 / 2026	0
Projekti: Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit	Data e publikimit: 12 Janar 2026 Data e dorëzimit: 12 Shkurt 2026	

7. Zëvendësimi i ekspertëve: Para nënshkrimit të kontratës, Ofertuesi i suksesshëm do të konfirmojë disponueshmërinë e ekipit kryesor të propozuar për zbatimin e kontratës. Mosplotësimi i kësaj kërkesë mund të rezultojë në refuzimin e ofertës. Megjithatë, zëvendësimi i ekspertëve do të merret në konsideratë vetëm nëse ndodh në rrethana jashtë kontrollit të Ofertuesit. Në një rast të tillë, Ofertuesi duhet të ofrojë një ekspert tjetër, me kualifikime dhe eksperiencë të barabartë ose më të mirë se eksperti fillestar, brenda 5 ditëve të punës nga data e njoftimit. Nëse eksperti zëvendësues nuk plotëson kushtet ose ndryshon kërkesat e Kërkesës për Tender, oferta mund të refuzohet dhe Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit mund të ftojë ofertuesin e renditur në vend të dytë.

8. Nënshkrimi i kontratës: Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga të dyja palët.

9. Ankesat: Ofertuesit jo të suksesshëm kanë të drejtë të paraqesin me shkrim kërkesë për sqarim ose ankesë në lidhje me procesin e prokurimit brenda 5 ditëve të punës nga data e marrjes dijeni të rezultateve përfundimtare të vlerësimit, në adresën e emailit tenders@bmf.al. Fondacioni do të kthejë përgjigje me shkrim brenda 5 ditëve të punës nga marrja e kërkesës për sqarim ose ankesës.

10. Anullimi i procesit të prokurimit: Fondacioni i Menaxhimit të Butrintit rezervon të drejtën të pranojë ose refuzojë cdo ofertë, të anulojë procesin e prokurimit dhe të refuzojë të gjitha ofertat në cdo kohë para dhënies së kontratës, pa patur ndonjë përgjegjësi ndaj Ofertuesve.

11. Informacion shtesë:

- 1- Të gjitha dokumentet e ofertës duhet të plotësohen plotësisht për të shmangur skualifikimin.
- 2- Nënkontraktimi nuk lejohet.
- 3- Ofertuesit jo të suksesshëm do të njoftohen mbi rezultatin e procesit të përzgjedhjes menjëherë pas nënshkrimit të kontratës me Ofertuesin e suksesshëm.

12. Periudha e Performancës: Produktet për këtë kontratë parashikohet të dorëzohen sipas fazave të mëposhtme:

- Afati i dorëzimit të projekt idesë - 2 muaj pas nënshkrimit të kontratës;
- Afati i dorëzimit të projektit teknik të zbatimit - 2 muaj pas marrjes së miratimit të projekt-idesë nga KKTKM;
- Afati i dorëzimit të projektit të zbatimit - 2 muaj pas marrjes së miratimit të projektit teknik të zbatimit nga KKTKM.

13. Kryerja e pagesave: Pagesa për kryerjen e punës së kërkuar do të kryhet sipas fazave të projektit në 3 këste të përshkruara këtu më poshtë:

- 10% me dorëzimin dhe miratimin e projekt idesë pranë KKTKM.
- 20% me dorëzimin e projektit teknik të zbatimit
- 70% me miratimin e projektit të zbatimit në KKTKM.

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 002 / 2026	0
Projekti: Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit	Data e publikimit: 12 Janar 2026 Data e dorëzimit: 12 Shkurt 2026	

14. Standardet e Performancës: Shërbimet duhet të ndërmerren brenda të gjitha rregullave, rregulloreve dhe ligjeve përkatëse në fuqi aktualisht në Shqipëri dhe nga praktikatat më të mira të industrisë.

Formulari nr. 1. FORMULARI I OFERTËS

Data:
Titulli dhe numri i referencës së prokurimit:
Për: Fondacioni i Menaxhimit të Butrintit
Ofertuesi:

Për Fondacionin për Menaxhimin e Butrintit,

Pasi kemi shqyrtuar dokumentet e Kërkesës për Tender të sipërpërmendur, ne ofrojmë të kryejmë shërbimet e kërkuara për shumën e llogaritur

Lekë (**Pa TVSH**)

(Me shifra dhe fjalë)

Oferta jonë është e vlefshme për 150 ditë kalendarike nga data e caktuar për afatin e dorëzimit të ofertës në përputhje me Dokumentet e Tenderit, dhe ajo do të mbetet e detyrueshme për ne dhe mund të pranohet në çdo kohë përpara skadimit të asaj periudhe;

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 002 / 2026	0
Projekti: Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit	Data e publikimit: 12 Janar 2026 Data e dorëzimit: 12 Shkurt 2026	

Për të ofruar çmimin e lartpërmendur, ne pranojmë se kemi marrë në konsideratë të gjitha dokumentet e shpallura të tenderit, duke përfshirë shtojcat.

Ne marrim përsipër që nëse oferta jonë pranohet të fillojmë ofrimin e shërbimit brenda _____ ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës dhe të përfundojmë në përputhje me kontratën brenda afatit kohor të rënë dakord me Fondacionin për Menaxhimin e Butrintit dhe në përputhje me informacionin në këto Dokumente Tenderi.

Ne e kuptojmë se ky Tender, së bashku me pranimin tuaj me shkrim të përfshirë në njoftimin tuaj për njoftimin e fituesit, do të përbëjë një kontratë detyruese mes nesh derisa të përgatitet dhe ekzekutohet një kontratë formale.

Ne e kuptojmë dhe pranojmë që Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit nuk është i detyruar të zgjedhë çmimin më të ulët ose ndonjë ofertë që mund të merret, dhe se çdo ose të gjitha ofertat mund të refuzohen pjesërisht ose plotësisht pa caktuar ndonjë arsye për një refuzim të tillë.

Nëse fitohet kontrata, personi i përmendur më poshtë do të veprojë si Përfaqësues i Kontraktorit:

_____ (Emri, mbiemri, nënshkrimi)

Përfaqësuesi ligjor¹

Ju lutemi bashkëngjitni buxhetin e detajuar

Formulari nr. 2. Buxheti i detajuar

Kjo kontratë është lump-sum. Buxheti i detajuar nevojitet për të paraqitur llogaritjet për vlerën totale të ofertës dhe për të llogaritur vlerën e shërbimeve shtesë, nëse do të jetë rasti.

Tabela 1. Pagesat për ekipin kryesor

Ekipi kryesor dhe pozicionet	Çmimi për ditë pune / muaj [zgjidh një të një]	Numri i ditëve / muajve [zgjidh një të një]	Totali në Lekë
Staf mbështetës			

¹ Në rastin e bashkimit të subjekteve, vendos emrat e anëtarëve të bashkimit të subjekteve dhe bashkëlidh autorizimin për përfaqësimin e bashkimit të subjekteve.

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 002 / 2026	0
Projekti: Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit	Data e publikimit: 12 Janar 2026 Data e dorëzimit: 12 Shkurt 2026	

Totali 1 pa TVSH			

Tabela 2. Shpenzime që lidhen me zbatimin e kontratës

<u>Përshkrimi</u> ²	Çmimi njësi	Sasia dhe njësia	Totali në Lekë
Totali 2 pa TVSH			

Totali (1+ 2) pa TVSH: _____**TVSH:** _____**Totali me TVSH:** _____**Formulari nr. 3. FORMULAR VETË - DEKLARIMI****A. DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PRANUESHMËRISË DHE KUALIFIKIMIT**

Deklarata
Ne jemi një kompani e regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit në fuqi.
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Ne nuk jemi të falimentuar apo në proces falimentimi dhe/ose likuidimi (statusi aktiv).

² Përkthyeri shpenzimet si transport, etj te nevojshme per zbatimin e kontrates.

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 002 / 2026	0
Projekti: Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit	Data e publikimit: 12 Janar 2026 Data e dorëzimit: 12 Shkurt 2026	

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Ne nuk jemi dënuar për një vepër penale dhe nuk jemi nën proces hetimi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Përfaqësuesi ligjor dhe aksionarët ose ortakët e shoqërisë nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe nuk janë nën proces hetimi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Ne nuk kemi proces gjyqësor të hapur në cilësinë e palës së paditur.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Ne kemi përmbushur detyrimet lidhur me pagesën e sigurimeve shoqërore dhe taksave sipas legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Ne nuk jemi dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale, përfshirë keqinterpretime serioze në dhënen e informacionit dhe shkelje të detyrimeve kontraktuale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Ne nuk po dorëzojmë Ofertë tjetër si Ofertues i vetëm apo anëtar i një bashkimi subjektesh.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Ne nuk jemi dhe kemi marrë masa të mos gjendemi në situata mashtrimi dhe korrupsioni.

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 002 / 2026	0
Projekti: Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit	Data e publikimit: 12 Janar 2026 Data e dorëzimit: 12 Shkurt 2026	

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Ne nuk jemi në asnjë prej situatave të konfliktit të interesit të përcaktuara në këtë Kërkesë për Tender.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Ne nuk jemi përfshirë në ndonjë listë me sanksione të lëshuar nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara, Kombet e Bashkuara ose Bashkimi Evropian, ose Agjencia e Prokurimit Publik.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

B. DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE DHE TERMAVE TË REFERENCËS

Deklarata

Ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha kërkesat, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe marrim përsipër të realizojmë shërbimin e kërkuar në përputhje me Termat e Referencës të përcaktuar nga Fondacioni i Menaxhimit të Butrintit.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Emri _____ Nënshkrimi _____ Data _____

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 002 / 2026	0
Projekti: Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit	Data e publikimit: 12 Janar 2026 Data e dorëzimit: 12 Shkurt 2026	

2. Deklarimi i Konfliktit të Interesit

Ofertuesi:

Unë, i nënshkruari

(Emri dhe numri i identitetit të përfaqësuesit ligjor)

Përfaqësues i

(Emri dhe adresa e kompanisë)

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 002 / 2026	0
Projekti: Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit	Data e publikimit: 12 Janar 2026 Data e dorëzimit: 12 Shkurt 2026	

Deklaroj se:

1. Unë ose kompania që përfaqësoj, **nuk** kemi asnjë marrëveshje kompensimi ose interes tjetër ose lidhje me ndonjë drejtor ose menaxher të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit.
2. Unë ose kompania që unë përfaqësoj, **nuk** kemi asnjë rrethanë tjetër që, në fakt ose në dukje, mund ta vështirësojë ushtrimin e pavarësisë, gjykimin objektiv ose në ndonjë mënyrë tjetër kryerjen me efektivitet të detyrave të mia si kontraktues, nëse zgjidhet.

Nëse ndonjë nga deklaratat më sipër nuk është e vërtetë ose kërkon shpjegim, ju lutemi përshkruani faktet përkatëse:

Emri _____ Nënshkrimi _____ Data _____

Formulari nr. 4. Eksperiencë e ngjashme

Ofertuesi:

PLOTËSONI NJË (1) FORMULAR PËR ÇDO KONTRATË DHE BASHKËLIDHNI KONTRATËN OSE REFERENCËN NGA INSTITUCIONI KONTRAKTUES

Kontratë me madhësi dhe natyrë të ngjashme

Identifikimi dhe përshkrimi i kontratës	
Kontratë e paraqitur në përgjigje të kërkesave për kualifikim ☐	Kontratë e paraqitur për pikë shtesë ☐

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 002 / 2026
Projekti: Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit	Data e publikimit: 12 Janar 2026 Data e dorëzimit: 12 Shkurt 2026

Data e fillimit		Data e përfundimit	
Roli në kontratë	Kontraktor kryesor		Nënkontraktor
Shuma totale e kontratës			
Shuma totale e komponentit të shërbimit (e rëndësishme nëse kontrata përmban elementë të ndryshëm nga shërbimet e tenderit, blerja e pajisjeve, mobiljeve etj.)			
Nëse është partneritet në një sipërmarrje të përbashkët ose nënkontraktor, specifikoni pjesëmarrjen në shumën totale të kontratës	Përqindja e totalit	Shuma	
Kontraktuar nga: Adresë Emri i kontaktit Numri i telefonit/celularit: E-mail:			
Përshkrimi i ngjashmërisë			

3. Punët në proces/Kontrata të zotuar

Ofertuesi:

Nr.	Emri dhe numri i projektit	Vlera e Kontratës	Adresa e Kontaktit të investitorit, Tel	Vlera e punës së përfunduar Lekë	Data e parashikuar e përfundimit	Data e përfundimit në kontratë
-----	----------------------------	-------------------	---	----------------------------------	----------------------------------	--------------------------------

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 002 / 2026	0
Projekti: Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit	Data e publikimit: 12 Janar 2026 Data e dorëzimit: 12 Shkurt 2026	

1						
2						
3						
4						
5						

Ofertuesit duhet të japin informacion në lidhje me **angazhimet e tyre aktuale** për të gjitha kontratat që i janë dhënë, ose për të cilat është marrë një letër angazhimi ose pranimi, ose për kontratat që i afrohen përfundimit, por për të cilat ende nuk është lëshuar një certifikatë përfundimi të plotë.

Formulari nr. 5. Ekipi kryesor i propozuar për këtë projekt

Ofertuesi:

Ju lutemi plotësoni formularin dhe bashkëngjitni CV-të, Diplomat dhe kontratat e përvojës së mëparshme ose referencat për Menaxherët dhe Specialistët kryesorë që do të punojnë në këtë projekt

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 002 / 2026	0
Projekti: Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit	Data e publikimit: 12 Janar 2026 Data e dorëzimit: 12 Shkurt 2026	

Nr	Emër Mbiemër	Data e lindjes	Arsimi	Detyra e caktuar	Licencat	Vite përvojë në detyrën e caktuar
1						
2						
3						
4						
5	...					
6	...					
7	...					
8	...					
9	...					
10	...					

Formulari nr. 6. Letra e Pranimit

[Data]

Drejtuar: [Emri dhe adresa e Ofertuesit fitues]

Procedura e prokurimit:

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 002 / 2026	0
Projekti: Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit	Data e publikimit: 12 Janar 2026 Data e dorëzimit: 12 Shkurt 2026	

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ju informojmë se oferta juaj e paraqitur më datë [_____], me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra] është pranuar nga Fondacioni i Menaxhimit të Butrintit.

Për sa më lart, ju kërkojmë që:

1. Të konfirmoni disponueshmërinë e ekipit kryesor të propozuar për zbatimin e kontratës, duke dorëzuar një Deklaratë Disponueshmërie të nënshkruar nga cdo ekspert.
2. Të nënshkruani dhe t'i ktheni Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit kontratën bashkëlidhur.

Për: Fondacionin e Menaxhimit të Butrintit

Emri dhe nënshkrimi:

Formulari nr. 7. Draft Kontrata

Draft kontrata do të finalizohet me Ofertuesin e suksesshëm

Sot më datë _____.____.2026, lidhet kjo kontratë shërbimi ("**Kontrata**") midis palëve të mëposhtme:

Fondacioni Për Menaxhimin e Butrintit, një organizatë jofitimprurëse e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar pranë Regjistrisë të Organizatave Jofitimprurëse me Vendim Gjykatë nr. 858,

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 002 / 2026	0
Projekti: Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit	Data e publikimit: 12 Janar 2026 Data e dorëzimit: 12 Shkurt 2026	

datë 22.07.2021, me NUIS: M12108451N, me seli në adresën “Parku Kombëtar i Butrintit, Rr. SH81, Kodi postar 9701”, përfaqësuar nga Znj. Jorida Muho (në vijim “**BMF**”),

dhe

_____një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar / person fizik, me adresë “_____” regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS: _____, përfaqësuar nga _____ (në vijim “**Ofruesi i Shërbimit**”).

Në vijim, veçmas referuar si “**Pala**” dhe së bashku “**Palët**”.

MEQENËSE:

- A.** BMF është themeluar nga Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë dhe Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (**AADF**) si një organizatë jofitimprurëse pa anëtarësim në formën e “fondacionit”.
- B.** BMF vepron në fushën e trashëgimisë kulturore, dhe në mënyrë specifike, qëllimi i saj është administrimi indirekt i nënzoneve të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, të Parkut Kombëtar të Butrintit, një pasuri me vlerë universale (“**Pasuria Kulturore**”), në përputhje me Ligjin Nr. 50/22 “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzoneve të Trashëgimisë Kulturore dhe Peizazhit Kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit” (“**Marrëveshja e Administrimit**”).
- C.** Qëllimet e BMF-së janë të administrojë, ruajë dhe mbrojë asetet e trashëgimisë kulturore të Pasurisë Kulturore. Misioni i BMF është të sigurojë akses publik dhe shërbime, si dhe të promovojë aktivitete studimore dhe kërkimore. Ky mision do të realizohet duke menaxhuar dhe zhvilluar Pasurinë kKulturore në mënyrën më të mirë të mundshme, duke siguruar mjetet financiare të nevojshme dhe personelin e specializuar për ruajtjen dhe zhvillimin e saj gjatë gjithë kohëzgjatjes së administrimit indirekt nga BMF.
- D.** Në zbatim të Planit të Menaxhimit të Integruar të Parkut Kombëtar të Butrintit dhe Planit të Menaxhimit të Konservimit Arkeologjik, BMF ka evidentuar gjendjen e Kalasë Veneciane, duke bërë një vlerësim të përgjithshëm strukturor të tyre dhe duke paraqitur problematikat e evidentuara dhe metodologjinë për ndërhyrjet e propozuara, të detajuara përmes një plan veprimi dhe kostot përkatëse.
- E.** Në vijim të sa më sipër, BMF shpalli thirrjen për kontraktimin e ekspertëve të fushës me qëllim ofrimin e shërbimit të “Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit”.
- F.** Për qëllim të sa më sipër, Ofruesi i Shërbimit është shpallur fitues i thirrjes, pasi në përfundim të shqyrtimit të ofertave, është vlerësuar si ofertuesi më i përshtatshëm nga pikëpamja teknike dhe financiare. Objekti i aktivitetit të Ofruesit të Shërbimit përfshin, ndër të tjera, ofrimin e shërbimeve të konsulencës, hartimin e planeve kombëtare, vendore, e sektoriale, hartimin e projekteve arkitektonike dhe projektme në fushën e infrastrukturës.
- G.** Duke marrë në konsideratë kushtet dhe rrethanat e mësipërme, Palët bien dakord të nënshkruajnë këtë Kontratë me qëllim formalizimin e marrëdhënies së tyre.

Në vijim të sa më sipër, Palët bien dakord si më poshtë:

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 002 / 2026	0
Projekti: Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit	Data e publikimit: 12 Janar 2026 Data e dorëzimit: 12 Shkurt 2026	

NENI 1 – OBJEKTI I KONTRATËS

- 1.1. Ofruesi i Shërbimit angazhohet të kryejë shërbimin e “Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit”, sipas Termave të Referencës bashkëngjitur kësaj Kontrate si Shtojca 1.
- 1.2. Me qëllim përmbushjen e shërbimeve të listuara në paragrafin 1.1 të këtij neni, Ofruesi i Shërbimit do të dorëzojë materialet e nevojshme, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në këtë Kontratë dhe shtojcave që i bashkëlidhen asaj si pjesë integrale.
- 1.3. Çdo shërbim i ofruar mbi bazën e kësaj Kontrate do të jetë në përputhje të plotë me kërkesat dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi për trashëgiminë kulturore.

NENI 2 – AFATI I KONTRATËS DHE I DORËZIMEVE

- 2.1. Kontrata hyn në fuqi menjëherë me nënshkrimin e saj nga Palët. Ofruesi i Shërbimit duhet të fillojë realizimin e shërbimeve brenda 2 (dy) ditëve pune pas nënshkrimit të kësaj Kontrate.
- 2.2. Projekt-ideja sipas Shtojcës 1, duhet të përgatitet dhe të dorëzohet për konsultim paraprak brenda 2 (dy) muajsh nga fillimi i punës sipas paragrafit 2.1 më sipër.
- 2.3. Paketa e plotë e dorëzimeve sipas Shtojcës 1 të kësaj Kontrate duhet të dorëzohet brenda 4 (katër) muajsh nga momenti i miratimit të projekt-idesë nga KTKM.
- 2.4. Kontrata do të mbetet në fuqi deri në përfundimin e afateve të përcaktuara dhe kryerjen e plotë të të gjitha shërbimeve të parashikuara në këtë Kontratë.

NENI 3 – SHPËRBLIMI DHE SHPENZIMET

- 3.1. Pagesa totale për shërbimet sipas kësaj Kontrate është **ALL _____ (_____ Lekë) pa TVSH**, dhe do të kryhet sipas fazave të mëposhtme:
 - a. 10% të shumës së përmendur në pikën 3.1., me dorëzimin dhe miratimin e projekt idesë pranë KTKM;
 - b. 20% të shumës së përmendur në pikën 3.1., me dorëzimin e projektit teknik të zbatimit;
 - c. 70% të shumës së përmendur në pikën 3.1., me miratimin e projektit nga KTKM.
- 3.2. Pagesat kryhen brenda 30 ditëve nga lëshimi i faturës tatimore dhe konfirmimit nga BMF për dorëzimin e produkteve
- 3.3. Tarifa për shërbimet sipas pikës 3.1 përfshin të gjitha shpenzimet e bëra nga Ofruesi i Shërbimit për kryerjen e shërbimeve sipas Shtojcës 1, përfshirë, nëse është e zbatueshme, çdo shpërblim për palë të treta konsulente ose nënkontraktore.
- 3.4. Përveç kur parashikohet ndryshe nga kjo Kontratë, Ofruesi i Shërbimit nuk do të marrë pagesa të tjera, shpërblime apo rimbursime shpenzimesh në lidhje me shërbimet sipas kësaj Kontrate. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Ofruesi i Shërbimit bie dakord që detyrimi i pagesës së tarifës për shërbimet sipas pikës 3.1 sipas kësaj Kontrate është detyrimi i vetëm i BMF për pagesë ndaj Ofruesit të Shërbimit.
- 3.5. BMF do të paguajë Ofruesin e Shërbimit përmes transfertës bankare në llogarinë:

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 002 / 2026	0
Projekti: Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit	Data e publikimit: 12 Janar 2026 Data e dorëzimit: 12 Shkurt 2026	

Emri i bankës: Banka xxxxx

Emërtimi i llogarisë: xxxx

Nr i llogarisë (Lek):

Iban:

NENI 4 – TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

4.1. Të drejtat dhe detyrimet e Ofruesit të Shërbimit

- 4.1.1. Ofruesi i Shërbimit angazhohet të kryejë shërbimet e projektimit sipas standardeve më të larta profesionale, duke respektuar afatet dhe duke siguruar materialet dhe personelin e nevojshëm për realizimin e detyrave të përcaktuara në Shtojcën 1.
- 4.1.2. Ofruesi i Shërbimit është përgjegjës për hartimin dhe dorëzimin e projektit në përputhje me standardet teknike dhe ligjore në fuqi, si dhe duke respektuar kërkesat specifike të përcaktuara në këtë Kontratë dhe në Termat e Referencës.
- 4.1.3. Ofruesi i Shërbimit ka detyrimin të sigurojë të gjitha pajisjet, softuerët, burimet teknike dhe personelin e specializuar të nevojshëm për kryerjen e shërbimeve sipas kësaj Kontrate.
- 4.1.4. Ofruesi i Shërbimit do të bashkëpunojë ngushtësisht me BMF gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit, duke informuar periodikisht dhe sa herë t'i kërkohet, mbi progresin e punimeve, problematikat e hasura, rekomandimet për zgjidhje dhe çdo zhvillim të rëndësishëm të projektit.
- 4.1.5. Ofruesi i Shërbimit, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës, duhet të zotërojë lejet, autorizimet, dhe licencat e nevojshme në përputhje me ligjin e zbatueshëm, me qëllim kryerjen e shërbimeve sipas kësaj Kontrate.
- 4.1.6. Ofruesi i Shërbimit është përgjegjës për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për paraqitje dhe mbrojtje të projektit pranë Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KTKM), si dhe për adresimin e çdo kërkesë për sqarim ose ndryshim të projektit që mund të kërkohet nga autoritetet përkatëse.
- 4.1.7. Ofruesi i Shërbimit duhet të sigurojë që të gjitha materialet e projektimit dhe dokumentet teknike të përgatiten në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në fuqi, standardet ISO, Manualin e Restaurimit dhe aktet nënligjore të përcaktuara në Termat e Referencës dhe Shtojcën 1.
- 4.1.8. Ofruesi i Shërbimit, personeli dhe çdo nënkontraktor i tij ndalohen të ndërmarrin çfarëdolloj Praktike të Ndaluar, që përfshijnë si vijon:
 - (i) praktikë shtrënguese, që nënkupton dëmtimin ose kërcënimin për të dëmtuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, çdo palë ose pronë të palës për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme në veprimet e një pale;
 - (ii) praktika e marrëveshjes së fshehtë, që nënkupton një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve të krijuara për të arritur një qëllim të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një pale tjetër;
 - (iii) praktikë korruptive, që nënkupton ofrimin, dhënien, marrjen ose kërkimin, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të çdo gjëje me vlerë për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme në veprimet e një pale tjetër;

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 002 / 2026	0
Projekti: Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit	Data e publikimit: 12 Janar 2026 Data e dorëzimit: 12 Shkurt 2026	

(iv) praktikë mashtruese, që nënkupton çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqinterpretim, që me vetëdije ose pakujdesi mashtron ose tenton të mashtrojë një palë për të përfituar një përfitim financiar ose ndonjë përfitim tjetër ose për të shmangur një detyrim; dhe

(v) vjedhje (përvetësim i pasurisë së palës tjetër).

(vi) ndalohen pagesat lehtësuese dhe dhuratat që tejkalojnë praktikën e arsyeshme të biznesit; Ofruesi zbaton gjithë legjislacionin antikorrupsion të zbatueshëm.

4.1.9. Ofruesit të Shërbimit i ndalohet gjithashtu edhe kryerja e pagesave lehtësuese dhe dhuratat/mikpritja që tejkalojnë praktikën e arsyeshme të biznesit. Në çdo rast, Ofruesi i Shërbimit do të veprojë në përputhje të plotë me të gjithë legjislacionin antikorrupsion të zbatueshëm.

4.1.10. Ofruesi i Shërbimit identifikon dhe menaxhon konfliktet e interesit, mban libra dhe evidenca të sakta të pagesave/transaksioneve dhe njofton menjëherë, e në çdo rast jo më vonë se 2 (dy) ditë pune, BMF (dhe, sipas rastit, Ministrinë/Autoritetin Kompetent sipas përkufizimit të dhënë në nenin 6, pika 6.4 të kësaj Kontrate) për çdo dyshim ose informacion në lidhje me përdorimin e një Praktike të Ndaluar. Ofruesi i Shërbimit miraton politika/kontrolle të brendshme dhe trajnon personelin për parandalimin e korrupsionit.

4.1.11. Ofruesi i Shërbimit siguron që çdo kontratë e tij me nënkontraktorë për shërbimet sipas kësaj Kontrate (nëse ka) të përmbajë dispozita të ngjashme me paragrafët 4.1.8–4.1.10 (si dhe detyrimet e konfidencialitetit të kësaj Kontrate) dhe bashkëpunon plotësisht me BMF/Ministrinë/Autoritetin Kompetent në çdo verifikim/auditim të arsyeshëm, duke vënë në dispozicion dokumentacionin përkatës. Çdo shkelje e paragrafëve 4.1.8–4.1.10 përbën shkelje thelbësore të Kontratës dhe i jep BMF-së të drejtën e zgjidhjes sipas nenit 6.

4.2. Të Drejtat dhe Detyrimet e BMF-së:

4.2.1. BMF ka të drejtë të monitorojë dhe vlerësojë cilësinë e shërbimeve të ofruara nga Ofruesi i Shërbimit, duke kërkuar në çdo kohë korrigjime apo ndërhyrje shtesë sipas nevojës dhe brenda afateve të arsyeshme.

4.2.2. BMF ka detyrimin të vërë në dispozicion informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm që i kërkohet nga Ofruesi i Shërbimit për realizimin e punimeve në mënyrë efektive.

4.2.3. BMF-ja do të kryejë pagesat ndaj Ofruesit të Shërbimit sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në Kontratë, pas marrjes dhe verifikimit të dokumentacionit dhe raporteve përkatëse të dorëzuara nga Ofruesi i Shërbimit.

4.2.4. BMF-ja ka të drejtë të kërkojë dhe të miratojë paraprakisht çdo ndryshim ose shtyrje afati që mund të ndikojë në realizimin e shërbimeve sipas kushteve të përcaktuara.

4.2.5. BMF-ja ka të drejtë të kërkojë në çdo kohë shpjegime dhe sqarime mbi projektin dhe punimet e dorëzuara nga Ofruesi i Shërbimit, për të siguruar përputhjen me objektivat e projektit dhe cilësinë e rezultateve finale.

4.2.6. BMF angazhohet të lehtësojë aksesin në zonë, nëse do të jetë e nevojshme, dhe të ofrojë bashkëpunim të plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës.

NENI 5 - KONFIDENCIALITETI

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 002 / 2026	0
Projekti: Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit	Data e publikimit: 12 Janar 2026 Data e dorëzimit: 12 Shkurt 2026	

Palët do të ruajnë konfidencialitetin e plotë mbi të gjithë informacionin e shkëmbyer gjatë zbatimit të kësaj Kontrate.

NENI 6 – ZGJIDHJA E KONTRATËS

- 6.1. Secila Palë ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e menjëhershme të kësaj Kontrate nëse Pala tjetër nuk përmbush ose shkel detyrimet e përcaktuara në nenin 4 të Kontratës.
- 6.2. Në rast të shkeljes së detyrimeve sipas nenit 4, Pala e prekur duhet t'i dërgojë Palës tjetër një njoftim me shkrim, duke përcaktuar qartë natyrën e shkeljes dhe duke kërkuar korrigjimin e saj brenda një afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh kalendarike nga data e marrjes së njoftimit.
- 6.3. Nëse Pala përgjegjëse për shkeljen e detyrimeve nuk merr masa për korrigjimin e shkeljes brenda afatit të parashikuar në pikën 6.2 më sipër, Pala e dëmtuar ka të drejtë të njoftojë me shkrim zgjidhjen e njëanshme dhe të menjëhershme të Kontratës, duke mos mbajtur përgjegjësi për dëmet e mundshme që mund të rezultojnë nga kjo zgjidhje.
- 6.4. BMF, me udhëzim të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (ose çdo autoriteti kompetent **“Autoriteti Kompetent”** apo pasardhësi ligjor si rezultat i riorganizimit të saj, **“Ministria”**) dhe/ose në rast mbarimi ose zgjidhjeje të parakohshme të Marrëveshjes së Administrimit, ka të drejtë të zgjidhë menjëherë këtë Kontratë, pa përgjegjësi dhe pa kosto shtesë për Ministrinë. Njoftimi i BMF-së prodhon efekt në datën e përcaktuar në të.
- 6.5. Me kërkesë të Ministrisë dhe/ose në rrethanat e pikës 6.4, BMF ka të drejtë të transferojë te Ministria të gjitha të drejtat dhe detyrimet e BMF sipas kësaj Kontrate, pa asnjë kosto shtesë për Ministrinë. Ofruesi i Shërbimit, nëpërmjet nënshkrimit të kësaj Kontrate, bie dakord dhe pranon çdo transferim të tillë, dhe angazhohet të bashkëpunojë plotësisht, përfshirë nënshkrimin e çdo dokumenti të domosdoshëm për bërjen efektiv të transferimit sipas kësaj pike.
- 6.6. Ofruesi i Shërbimit nuk do të ngrejë asnjë pretendim, kërkesë apo padi ndaj Ministrisë apo Autoritetit Kompetent në lidhje me (i) zgjidhjen e kësaj Kontrate sipas pikës 6.4 dhe/ose (ii) transferimin e saj sipas pikës 6.5. Çdo pretendim i Ofruesit të Shërbimit që lidhet me periudhën para transferimit ushtrohet vetëm kundrejt BMF.
- 6.7. Në rast zgjidhjeje të Kontratës sipas këtij neni, ose transferimi të saj sipas pikës 6.5, Ofruesi i Shërbimit do të: (a) dorëzojë te BMF/Ministria/Autoriteti Kompetent menjëherë të gjitha produktet e punës, dokumentacionin teknik, materialet dhe çdo të drejtë përdorimi të lidhur me to; (b) ndërmarrë të gjitha veprimet e arsyeshme për të siguruar transferimin pa pengesa të Shërbimeve; dhe (c) transferojë ose vërë në dispozicion të BMF/Ministrisë/Autoritetit Kompetent çdo kontratë me nënkontraktorë (nëse ka), sipas udhëzimeve të BMF/Ministrisë/Autoritetit Kontraktor.
- 6.8. Asnjë nga veprimet e mësipërme nuk do të krijojë kosto shtesë për Ministrinë/Autoritetin Kompetent, dhe nuk cenon të drejtën e Ofruesit të Shërbimit për të marrë pagesat e pakontestuar për punën e pranuar deri në datën e zgjidhjes, ose transferimit.
- 6.9. Zgjidhja e Kontratës sipas këtij neni nuk e përjashton të drejtën e Palës së dëmtuar për të kërkuar dëmshpërblim në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 002 / 2026	0
Projekti: Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit	Data e publikimit: 12 Janar 2026 Data e dorëzimit: 12 Shkurt 2026	

NENI 7 – PUBLIKIMET DHE KOMUNIKIMET

- 7.1. Ofruesi i Shërbimit pranon se nuk do të bëhet asnjë publikim mbi shërbimet dhe rezultatet e punës sipas objektit të kësaj Kontrate, pa miratimin paraprak me shkrim të BMF.
- 7.2. Në rast se pas përfundimit të afatit të kësaj Kontrate, Ofruesi i Shërbimit synon të publikojë të gjithë ose një pjesë të rezultateve të shërbimeve të kryera për BMF ose ta përmendë atë në ndonjë rast publik, Ofruesi i Shërbimit merr përsipër, edhe pas përfundimit të afatit të kësaj Kontrate, t'i dorëzojë BMF, për miratim, projektin jo përfundimtar të publikimit.
- 7.3. Dispozitat e këtij neni do të vazhdojnë edhe pas zgjidhjes së parakohshme ose përfundimit të afatit të Kontratës.

NENI 8 – PËRGJEGJËSIA E OFRUESIT TË SHËRBIMIT

- 8.1. Ofruesi i Shërbimit do të zhdëmtojë dhe do të shkarkojë BMF nga çdo përgjegjësi për dhe kundrejt të gjitha humbjeve dhe dëmeve që janë rezultat i fajit të Ofruesit të Shërbimit në kryerjen e shërbimeve sipas kësaj Kontrate dhe detyrimeve të tij lidhur me to.
- 8.2. Ofruesi i Shërbimit do të jetë përgjegjës për aplikimin dhe mbajtjen në fuqi të të gjitha lejeve, autorizimeve dhe miratimeve të nevojshme që lidhen me kryerjen e shërbimeve sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate.

NENI 9 – MBAJTJA E PAGESAVE

- 9.1. BMF do t'i mbajë nga pagesa Ofruesit të Shërbimit, duke anuluar të gjithë apo një pjesë të pagesës së miratuar, në një masë të tillë sa është e nevojshme për të mbrojtur BMF nga humbjet gjatë kësaj Kontrate të cilat vijnë për shkak të:
- (a) moskryerjes së shërbimeve nga Ofruesi i Shërbimit, me përjashtim të rasteve kur mospërbushja vjen për shkaqe që nuk varen nga ai;
 - (b) mospërbushjes nga Ofruesi i Shërbimit dhe/ose rezultatit të pakënaqshëm të shërbimeve, kur BMF i ka tërhequr më parë vëmendjen.
- 9.2. Ndalimi në pagesa nga BMF ndaj çdo pagese të ndërmjetme nuk do të ndikojë në detyrimin e Ofruesit të Shërbimit për të vazhduar përbushjen e shërbimeve sipas kësaj Kontrate.
- 9.3. Asnjë interes nuk do të aplikohet mbi pagesat e mbajtura nga BMF në zbatim të kushteve të këtij neni.

NENI 10 – PAJTUESHMËRIA ME LIGJIN NË FUQI

- 10.1. Palët angazhohen të zbatojnë të gjitha rregullat dhe ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe rregulloret e politikave të BMF. Ofruesi i Shërbimit do të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme që kërkohen për përbushjen e kësaj Kontrate.
- 10.2. Ofruesi i Shërbimit nuk duhet të kryejë veprime të cilat janë të ndaluara nga ligjet dhe rregullat në fuqi.

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 002 / 2026	0
Projekti: Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit	Data e publikimit: 12 Janar 2026 Data e dorëzimit: 12 Shkurt 2026	

NENI 11 - ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me këtë Kontratë dhe që nuk mund të zgjidhet me bisedime midis Palëve, do të zgjidhet nga gjykata kompetente në Republikën e Shqipërisë.

NENI 12 - LIGJI I ZBATUESHËM

Kjo Kontratë rregullohet dhe interpretohet në bazë të ligjit të Republikës së Shqipërisë.

NENI 13 - NJOFTIMET

Çdo njoftim sipas kësaj Kontrate bëhet me shkrim dhe dërgohet në adresat e mëposhtme:

PËR BMF:

Adresa fizike: Parku Kombëtar i Butrintit, Rr. SH81, Kodi postar 9701

E-mail:

Tel:

PËR OFRUESIN E SHËRBIMIT:

Adresa fizike:

E-mail:

Tel:

NENI 14 – SHTOJCAT

Palët bien dakord se Shtojca 1 bashkëlidhur kësaj Kontrate është pjesë integrale dhe e pandarë e saj. Ofruesi i Shërbimit do t'i përmbahet në çdo kohë kriterëve dhe udhëzimeve të përcaktuara në Shtojcën 1.

Kjo Kontratë u nënshkrua në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe nga Palët e mëposhtme:

BMF

OFRUESI I SHËRBIMIT

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 002 / 2026	0
Projekti: Studim Projektim Restaurimi dhe Interpretimi i ri i Kalasë Veneciane në Akropolin e Butrintit	Data e publikimit: 12 Janar 2026 Data e dorëzimit: 12 Shkurt 2026	

SHTOJCA 1

TERMAT E REFERENCËS